

UDHËZIM
Nr.21 datë 05.04. 2001

**PËR VENDOSJEN E KOPJEVE ORIGJINALE TË TABELAVE, PROCES-VERBALEVE
DHE VULËS SË KQV NË KUTINË E VOTIMIT QË PËRMBAN FLETËT E VOTIMIT PËR
DEPUTET NË ZONËN NJËMËRORE**

Në bazë të nenit 106 pika 6 e ligjit nr.8609, datë 08.05.2001 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", KQV-ja pas numërimit të fletëve të votimit, për deputet të drejtpërdrejtë në zonën njëmërore, zarfet me fletët e votimit i fut në kutinë e votimit, të cilën e vendos mënjatë. Mbi bazën e fletëve të votimit të numëruara plotësohet "Tabela e Rezultateve të Qendrës së Votimit Nr. _____, për deputet të drejtpërdrejtë në Zonën Zgjedhore Nr. _____" (Modeli 54).

Pas kësaj, përsëriten procedurat e numërimit të fletëve të votimit për deputet me lista shumemërore dhe më pas plotësohet "Tabela e Rezultateve të Qendrës së Votimit Nr. _____ të Zonës Zgjedhore Nr. _____ për deputet me lista shumemërore" (Modeli 55).

Pas plotësimit të tabelave Model 54 dhe 55, kryetari i KQV-së plotëson "Tabelën e Përgjithshme të Rezultateve të Qendrës së Votimit Nr. _____ të Zonës Zgjedhore Nr. _____", e cila përmbledh të dhënat e dy tabelave të mësipërme, Modelet 54 dhe 55.

Kopjet origjinale të tre tabelave (Modelet 54, 55 dhe 56), procesverbalet dhe vula e KQV-së vendosen në kutinë e votimit që përmban fletët e votimit për deputet të drejtpërdrejtë të zonës njëmërore. Një kopje e plotësuar e Tabelës së Përgjithshme të Rezultateve të Qendrës së Votimit (Modeli 56) vendoset në një zarf të posaçëm, i cili nuk vendoset në kutinë e votimit.

Dy kutitë e votimit vulosen me vulat jeshile dhe numrat identifikues të vulave regjistrohen në procesverbal.

Kryetari dhe sekretari i KQV-së i dorëzojnë KZZ-së përkatëse, brenda 24 orëve nga mbyllja e votimit, kutitë e votimit dhe zarfin me procesverbalet e votimit.

KZZ-ja i lëshon kryetarit të KQV-së një procesverbal dorëzimi.

Shënim: Asnjë material tjetër zgjedhor nuk futet në kutitë e votimit.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi